



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1034

OSHP: 2024/1035

OSHP: 2024/1047

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga zv. Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim- Kryesuese, Vedat Poterqoi dhe Kimete Gashi-Brajshori-Anëtar të Panelit duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Medi Health” L.L.C., OE N.T.SH "M.S.Medicom", si dhe ankesës së OE “Interlab” SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Ministrisë së Shëndetësisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën ne Podujevë” me numër të prokurimit 206-24-8799-1-1-1, me 10/12/2024, mori;

Vendim

1. Aprovohen si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Medi Health” L.L.C. me nr. 2024/1034, e datës 25/10/2024, ankesa e OE N.T.SH "M.S. Medicom" me nr. 2024/1035, e datës 25/10/2024, “Interlab” SH.P.K., me nr. 2024/1047 e datës 28/10/2024, kurse vendimi i AK Ministria e Shëndetësisë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën ne Podujevë” me numër të prokurimit 206-24-8799-1-1-1

2. Mbetet në fuqi B58Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë, në lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik ankues sipas nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së punës së OSHP-së.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 26.08.2024, Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën ne Podujevë” me numër të prokurimit 206-24-8799-1-1-1. Publikimi i njoftimit për kontratë është bërë me datë: 26.08.2024. Publikimi i formularit mbi korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara është bërë me datë: 20.09.2024. Hapja e ofertave është bërë me datë: 23.09.2024, ora: 14:00:00.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar: procedurën e hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës për Lot 3 është: 405,000.00 €.

Me 29.10.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë.

Me datën 14.10.2024 operatorët ekonomik “Medi Health” L.L.C, OE N.T.SH."M.S.Medicom" si dhe OE “Interlab SH.P.K”. Me datën 17.10.2024 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorëve ekonomik.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën ne Podujevë” me numër të prokurimit 206-24-8799-1-1-1, me datën 25.10.2024, OE ankues “Medi Health L.L.C” ka parashtruar ankesë me nr. 2024/1034 si dhe OE N.T.SH."M.S.Medicom" ankues ka parashtruar ankesë me nr. 2024/1035. Me datën 28.10.2024 “Interlab SH.P.K” me nr. protokolli 2024/1034.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 1034/2024 ankesa nr. 1035/2024 dhe 1047/2024 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të

Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet ankimore të Operatorëve Ekonomik ankues në OSHP

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Medi Health” L.L.C Nr. 1034/2024 janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi ankimor 1: Operatori ekonomik - “Medi Health L.L.C.”- Prishtinë, pretendon se oferta e propozuar për dhënie të kontratës në Lot-in 3 për procedurën e prokurimit “Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën ne Podujeve” me nr. të prokurimit: "206-24-8799-1-1-1", është e papërgjegjshme dhe se kjo është arsyeja që AK, përkundër bazës ligjore u’ka mohuar ofrimin e qasjes në dokumente zyrtare. Sipas OE ankues, mohimi i qasjes në dokumentacionin publik është shkelje esenciale e ligjit për prokurim publik. OE ankues pretendon që AK nuk ka vepruar në pajtim me nenin 10 dhe 11 të LPP-së.

Sipas “Medi Health L.L.C.”- Prishtinë, kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, aspekti administrativ, ISO certifikatat, aspekti teknik dhe raportet e produkteve, katalogët broshurat e produkteve dhe autorizimet, nuk mund të klasifikohen si sekret afarist. Sekret afarist mund të konsiderohen vetëm të dhënat personale. OE ankues pretendon që AK në pajtim me paragrafin 4 të nenit 11 të LPP-së është dashtë të përgatisë versionin e pastruar të dokumenteve ndaj OE-ve të cilët i kanë deklaruar ofertat si të tilla.

E drejta për qasje në dokumente publike sipas OE ankues është e drejtë bazike e garantuar me nenin 41 të Kushtetues së Republikës së Kosovës. Po ashtu qasja e plotë në dokumente publike është e garantuar edhe me paragrafin 3.2 të nenit 17 të ligjit nr. 06/L081, për Qasje në Dokumente Publike, si dhe me nenin 12, 13 dhe 14, të ligjit nr. 06/L – 082, për Mbrojtjen e të dhënave personale.

Pretendimi ankimor 2: OE ankues po ashtu pretendon se, OE i rekomanduar për dhënie të kontratës në Lot 3 është i papërgjegjshëm, me faktin se gjatë qasjes në dokumente zyrtare i është ofruar qasje në dokumentin “Deklaratë për Specifikacione Teknike të Detyrueshme”, dokument ky në të cilin thuhet: OE ankues pretendon se me këtë deklaratë vet kompania re propozuar për dhënie të kontratës tregon se nuk ka paraqitur specifikacionet teknike të detyrueshme. *Në pikën 9.1 dhe 9.2 të FDT-së tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional në kërkesën nr. 2 është kërkuar: Kërkesa 2. Operatori Ekonomik duhet të prezantojë katalogun (broshurën) e pajisjeve të ofruara, ku produktet dhe specifikat teknike të ofruara duhet të jenë të nënvizuara qartë. Në rast se prezantohet broshura, duhet të specifikohet edhe linku i faqes zyrtare të prodhuesit ne internet, ku mund të gjendet kjo broshurë. Dëshmia 2. Katalogu (broshura) e pajisjeve të ofruara me selektim të qartë të produkteve dhe specifikave teknike të ofruara, së bashku me linkun e faqes se prodhuesit.*

Mbështetur në dokumentet e dërguara pas kërkesës për qasjes, sipas “Medi Health L.L.C.”, OE i rekomanduar për dhënie të kontratës është i papërgjegjshëm, sepse nuk ka ofertuar me produktet konform kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Pretendimi ankimor 3: OE ankues pretendon se Komisioni i vlerësimit – ZPP, kanë bërë shkelje ligjore kur kanë rekomanduar për dhënie të kontratës një OE të cilin e konsideron të papërgjegjshëm. “Për cdo procedurë të prokurimit është obligim ligjor që para vlerësimit të ofertave secili anëtar i komisionit të vlerësues të nënshkruaj deklaratë nën betim për vlerësim të drejtë dhe korrekt të ofertave. Me nenin 59, paragrafi 1 të LPP-së, përgjegjësia është individuale ndaj secilit anëtar madje tani i implikuar edhe zyrtari përgjegjës i prokurimit”.

OE i rekomanduar për dhënie të kontratës sipas OE ankues nuk i plotëson kërkesat kualifikuese të përcaktuara në dosje të tenderit dhe specifikacionet teknike për produktet dhe pajisjet e ofruara. Më këtë rast OE ankues pretendon se është shkelë neni 97 i RrPP-së.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “N.T.SH."M.S.Medicom" Nr. 1035/2024janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi ankimor 1: Operatori ekonomik - N.T.SH."M.S.MEDICOM"- Prishtinë, pretendon që AK – Ministria e Shëndetësisë ka vepruar kundërligjshëm, me rastin e eliminimit të kësaj kompanie nga aktiviteti i prokurimit: (LOT 3) “Furnizim me pajisje mj ekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën ne Podujeve” -1”, dhe ka rekomandimit për dhënie të kontratës, një OE, të cilin e konsideron të papërgjegjshëm dhe me çmim për 60 mijë euro më të shtrenjtë se sa oferta e OE ankues. Me këtë veprim OE ankues pretendon se, AK ka shkelur parimet bazë të LPP-së, përkatësisht nenin 1, nenin 59 dhe nenin 60 të LPP-së. N.T.SH."M.S.MEDICOM" nuk është pajtuar me arsyetimin mbi eliminim, për arsyet si në vijim: “OE Medicom ka ofertuar me çmime zero. Kjo nuk është e saktë për shkak se:

1. MS Medicom ka ofertuar në LOT 3 me çmime të tregut dhe nuk ka ofruar me çmime zero (0);
2. MS Medicom, si distributor i kompanisë lidere evropiane Fresenius Medical Care Gjermani, ka qenë i detyruar të ofertojë në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe e ka pasur të ndaluar të faturojë Ministrinë e Shëndetësisë për shërbimet e instalimit të pajisjeve të shitura të reja të përfshira në çmim në kuadër të LOT 3 (pjesa 1, 2 dhe 3), dhe rrjedhimisht e ka pasur të ndaluar të faturojë edhe pjesën 4 të LOT 3
3. MS Medicom e ka pasur ligjërisht të ndaluar të faturojë dyfish Autoritetin kontraktues, kjo pasi ky do ishte abuzim me legjislacionin e Kosovës dhe të Bashkimit Evropian për mbrojtjen e konkurrencës. Për më tepër, kjo ka qenë Kontratë Furnizimi, dhe jo shërbimeve”.

Pretendimi ankimor 2: OE ankues pretendon se, AK ka vepruar kundër ligjshëm duke mos lejuar qasje në emrin e prodhuesit dhe pajisjet e ofruara të operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës. N.T.SH."M.S.Medicom" në ankesën drejtuar OSHP-së ka shfaqë dyshime se oferta e të rekomanduarit për Kontratë është e papërgjegjshme dhe se Autoriteti Kontraktues ka vepruar kundërligjshëm me refuzimin e qasjes në pajisjet e ofruara dhe ofertën e palës së rekomanduar. Fakti se OE ka paraqitur Kërkesë për të klasifikuar sipas OE ankues, një dokument të tenderit si Sekret Afarist, nuk e bënë informacionin sekret. Lidhur me Kërkesën, AK duhet të vendosë me Vendim të veçantë me shkrim, nëse e njëjta - Kërkesa - i plotëson kushtet ligjore për

t'u trajtuar si informacion sekret, të cilat rrjedhin nga Neni 11, paragrafi 3, i LPP-së. Kushtet që një informacion të trajtohet si Sekret Afarist janë të detajuara dhe, ndër të tjera, duhet të ketë arsyetim të detajuar si dhe prova se publikimi i një informacioni të tillë shkakton dëm. Në rast se AK vendosë që një dokument i caktuar, specifikisht i identifikuar, përmban Informacion Sekret Afarist, atëherë, në bazë të paragrafit 4 të Nenit 11 të LPP-së, duhet të përgatisë versionin e “pastruar” të atij dokumenti. Kjo duke e pastruar vetëm Informacionin Sekret Afarist dhe duke e lënë tërë dokumentin tjetër për inspektim. Neni 11, paragrafi 4, i LPP-së, përcakton që: “Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përgatit versionin e “pastruar” të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka qasje publiku dhe palët e interesuara sipas nenit paragrafit 3. OE ankues pretendon se, në rast se AK ka marrë Vendim që ndonjë dokument të dosjes së kërkuara ta cilësojë si sekret, OE Ankues kërkon nga i njëjti që të tregojë specifikisht se cilat dokumente AK i ka pranuar si sekrete dhe t'ia dërgojë versionin e pastruar të të njëjtave. Në të kundërtën, AK do të shkelte Nenet 10, 11 dhe 59 të LPP-së.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Interlab” SH.P.K Nr. 1047/2024 janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi ankimor 1: OE “Interlab” SH.P.K. në ankesën drejtuar OSHP-së pretendon se, AK – Ministria e Shëndetësisë nuk është dashur ti klasifikojë të gjitha dokumentet e nenit 68 dhe 69 të LPP-së si sekret afarist. “AK nuk mund të klasifikojë si sekret afarist asnjëherë “Katalogun e Prodhuesit” sipas Nenit 11 Paragrafi 3 Pika 1, 2 dhe 3 të LPP-se, sepse është dokumentet i prodhuesit ku mbi bazën e tij gjatë vlerësimit konstatohet se a plotëson kërkesat teknike të dosjes se tenderit. OE ankues pretendon se, në pajtim me nenin 1, 6, 7 dhe 59 të LPP-së AK-ja asnjë dokument nuk duhet ta aprovoj si sekret afarist sepse një procedurë e prokurimit duhet të përcjellët me transparencë, trajtim të barabartë dhe vlerësim të tenderëve në pajtim me kërkesat e dosjes se tenderit që në këtë rast AK ka shkelur të gjitha këto parime bazë të neneve të LPP-së. “CE certifikatat dhe Katalogu i prodhuesit nuk paraqesin asnjë rrezik të dëmtimit komercial të grupit sepse këto dokumente janë të prodhuesit. Përmes katalogut të prodhuesit ne si ankues mund të konstatojmë se Grupi i OE a i ka plotësuar specifikimet teknike te detyrueshme Aneksi 1 te dosjes se tenderit, ndërsa mos ofrimi i katalogut nuk mundëson në asnjë mënyre që të vërtetojmë këtë pretendim ankimor”.

Pretendimi ankimor 2: OE ankues pretendon se certifikata Nr.: W-240837-Q e lëshuar nga WQR International Certification Ltd (si trup certifikues) për OE Medica si pjesë e grupit të OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, është i rremë sepse Institucioni - Word Accreditation Services (trup akreditues) nuk është i akredituar për të lëshuar një dokument të tillë. “Për të vërtetuar se dokumenti i dorëzuar nga OE Medica është i rreme ju lutem referojuni Uebsite zyrtare te Word Accreditation Services ku pretendon se bënë pjesë në IAF, pra trup akredituese nga IAF referuar Uebsite të tyre <http://theëas.us/about-ëas.php>, por ne realitet “Word Accreditation Services” nuk është pjese e IAF dhe as e akredituar nga IAF (si trup akreditues)

për të ofruar shërbime te tilla apo për te autorizuar kompani tjera”. Se nuk është pjese e IAF, sipas Interlab SH.P.K. vërtetohet fare thjeshte duke kërkuar ne linkun si me poshtë, qe paraqet listën e trupave akreditues dhe pjesëtarëve: <https://iaf.nu/en/accreditation-bodies/> “Ne këtë link mund te kërkohe emrat e kompanive që janë te pajisur me certifikata valide, ndërsa Word Accreditation Services nuk figuron të ketë data bazë dhe nuk është e akredituar”.

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar dokument të rremë dhe këtë e ka vërtetuar nëpërmjet email-it zyrtar, pasi kanë kontaktuar kompaninë IAF dhe të njëjtit kanë pranuar se “Word Accreditation Services” nuk është pjese e IAF dhe as e akredituar nga IAF (emaili është bashkëngjitur në ankesën drejtuar OSHP-së).

Pretendimi ankimor 3: OE ankues pretendon se, nga qasja e marrë tek dokumenti - Përshkrimi i çmimit, janë një numër i konsiderueshëm i pozicioneve me prodhues që për të njëjtit në linjat e tyre të produkteve nuk gjinden produktet e kërkuara në Dosjen e Tenderit: “Në pozicionet 8,14 dhe 27 si prodhues është deklaruar GIMA S.p.A., ku në realitet specifikacionet teknike të linjës së produkteve të këtij prodhuesi për këto pozicione nuk përkojnë me specifikacionet teknike të produkteve të kërkuara nga AK në Dosjen e Tenderit. Po ashtu, për produktet në pozicionet 26 - Lift elektrik për transport të pacientëve-komplet Pajisje mjekësore – Spirometer, 29- Pajisje mjekësore – Spirometer, 35- Makinë për ngjitjen e qeseve sterilizuese komplet dhe 36 - Pajisje për prerjen e rollneve sterilizuese tek përshkrimi i çmimit po ashtu është deklaruar si prodhues GIMA S.p.A, ku në faqe të këtij prodhuesi tek ISO-të dhe CE-të tek këto produkte shohim se në fakt prodhuesi është tjetër dhe GIMA S.p.A është distributor për këto produkte (shih linqet e mëposhtme). Tek pjesa e përshkrimit të çmimit është bërë deklarimi i gabuar i prodhuesit dhe vendit të origjinës së produkteve.

- Art.26 https://www.gimaitaly.com/prodotti.asp?sku=27753&dept_selected=24&dept_id=252
- Art.29 https://www.gimaitaly.com/prodotti.asp?sku=33519&dept_selected=56&dept_id=562
- Art.35 https://www.gimaitaly.com/prodotti.asp?sku=35915&dept_selected=66&dept_id=668
- Art.36 https://www.gimaitaly.com/prodotti.asp?sku=35900&dept_selected=66&dept_id=668

Për artikujt:

- Art.85 – Telefon për zyre
- Art. 130- Paletar elektrik (Pirunar) - mjet për bartjen e materialit shpenzues. Rekomandim: Duhet të furnizohet me Paletar elektrik (Pirunar) për bartjen e materialit shpenzues
- Art.155 – Furnizim me rezervuar 15000-200000 L

Prodhuesi i deklaruar në përshkrimin e çmimit nga O.E “MADEKOS dhe MEDICA sh.p.k” është ARI-KINA, gjë që nuk qëndron, pasi që prodhuesi ARI nuk i posedon këta artikuj në linjën e produkteve.

Vërtetimin mund t’a gjeni në linkun e mëposhtëm dhe produktet që i prodhon ARI:

- <https://www.ari-cn.com/list-Product.html>

Për Art. 120. Peshorja Multifunksionale për matjen e peshës së pacientit së bashku me karrocë. Rekomandohet që kapaciteti i matjes të jetë deri në 300-400 kg. Prodhuesi i deklaruar në përshkrimin e çmimit nga O.E “Madekos dhe Medica sh.p.k është GIMA S.P.A, nëse shikojmë ne katalogun e GIMA S.P.A , peshore për matjen e peshës se pacientit së bashku me karrocë është e kapacitetit deri 200kg dhe nuk e plotëson kriterin prej 300-400kg, gjithashtu GIMA S.P.A është vetëm distributor i këtij produkti dhe prodhuesi ne baze te deklaratës se konfomitetit është SOEHNLE.

Pasi që në përshkrimin e çmimit nga O.E “Madekos dhe Medica sh.p.k”, është deklaruar si prodhues GIMA S.P.A, ne dyshojmë që O.E nuk e posedon autorizimin e prodhuesit nga kompania SOEHNLE., por vetëm nga distributori GIMA S.P.A, gjë që bien ndesh me kërkesën e AK-së në pikën 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Kërkesa 3. Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se është i autorizuar nga prodhuesi për të marrë pjesë në tender ose nga përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit. Në rastin e dorëzimit të autorizimit nga përfaqësuesi kërkohet të dëshmohet edhe autorizimi ne mes prodhuesit me përfaqësuesin. Për Art.145 - Barelë për bartjen e pacientëve. Prodhuesi i deklaruar në përshkrimin e çmimit nga O.E “Madekos dhe Medica sh.p.k është GIMA S.P.A, por pas hulumtimeve që kemi bërë në website kemi vërtetuar që prodhuesi është nga kompania kineze: Jiangyin Everise Medical Equipment Co.,Ltd 1001 Chengyang Road,Jiangyin City, Jiangsu,China, Pra GIMA S.P.A është vetëm distributor i saj.

Në linkun e mëposhtëm e vërtetoni me ISO dhe CE të prodhuesit të ngarkuar në faqen e GIMA S.P.A:

o https://www.gimaitaly.com/prodotti.asp?sku=34103&dept_selected=634&dept_id=6342

Pasiqë në përshkrimin e çmimit nga O.E “Madekos dhe Medica sh.p.k”, është deklaruar si prodhues GIMA S.P.A, ne dyshojmë që O.E nuk e posedon autorizimin e prodhuesit nga kompania kineze, por vetëm nga distributori GIMA S.P.A, gjë që bien ndesh me kërkesën numër 3 AK-së në pikën 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale: Kërkesa 3. Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se është i autorizuar nga prodhuesi për të marrë pjesë në tender ose nga përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit. Në rastin e dorëzimit të autorizimit nga përfaqësuesi kërkohet të dëshmohet edhe autorizimi ne mes prodhuesit me përfaqësuesin.

-Vlerësimi dhe administrimi i provave-

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 27.06.2024 ka autorizuar eksperten shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1034/24, 1035/24 dhe 1047/24 ndërsa me datë 10.11.2024 janë dorëzuar raportet e ekspertizës të ekspertit shqyrtuese.

Lidhur me ankesën nr. 1034/24 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1: “Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurim vlerëson se, në zbatim të dispozitës ligjore sipas nenit 11 të LPP-së, AK duhet të ofroj qasje në dokumentet e kërkuara sipas rregullave të lejuara. Në rastin kur dokumentet e caktuara paraqiten si dokumente konfidenciale dhe si të tilla pranohen edhe nga ana e autoritetit kontraktues, atëherë në këtë rast AK sipas këtij neni duhet të krijoj një version të pastruar duke larguar apo fshirë disa elemente të caktuara të informatave në dokumentet përkatëse të cilat janë cilësuar si sekret afarist.

Shih në vijim paragrafin 4 të nenin 11 të LPP-së: *4. Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përgatit versionin e “pastruar” të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka qasje publiku dhe palët e interesuara sipas nenit paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të versionit të tillë të pastruar një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar disa elemente të caktuara të informatës në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesën e operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) versioni i pastruar i bashkëngjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe është një kopje e saktë e origjinalit pas heqjes ose fshirjes së informatave të tilla sekrete afariste.*

AK mos ofrimin e qasjes në dokumentet të cilat janë klasifikuar nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës si sekret afarist, në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, e ka arsyetuar si në vijim: *”Neni 11 qartëson se AK ka detyrim të respektojë kërkesat për sekret afarist të paraqitura në OE, për sa kohë këto kërkesa plotësojnë kushtet e përshkruara në ligj. Sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së, operatorët ekonomik kanë të drejtë të kërkojnë që informacionet komerciale të mbrohen si sekrete afariste nëse ato përmbushin kriteret ligjore”.*

AK në kërkesën për rishqyrtim po ashtu ka pohuar se, kërkesë për sekret afarist është dorëzuar nga të gjithë OE-të pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, përfshirë edhe operatorin ankues “Medi Health L.L.C.”, për të cilin ka ofruar dëshmi se ka kërkuar sekret afarist për dokumentet si në vijim:

- Autorizimet e kompanive prodhuese;
- Certifikatat e kompanive prodhuese;
- Katalogët dhe deklaratat.

Pavarësisht se AK ka vlerësuar se kërkesa për sekret afarist është e drejtë ligjore dhe se janë trajtuar barabartë të gjithë OE të cilët kanë kërkuar që informacionet komerciale të mbrohen si sekrete afariste, përfshirë këtu edhe OE ankues i cili po ashtu ka dorëzuar një kërkesë të tillë, Eksperti shqyrtues vlerëson se, AK duhet të veprojë në pajtim me nenin 11 të LPP-në dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsideroj se të gjitha kërkesat kualifikuese në kuadër të nenit 68 dhe nenit 69 të LPP-së të konsiderohen sekrete afariste”.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2: Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurimi, përkatësisht pretendimit ankimor të OE ankues vlerëson se, Autoriteti Kontraktues në pajtim me paragrafin 1 të nenit 72 të LPP-së, duhet të bëjë sqarim të tenderit, kjo duke pas parasysh edhe dokumentet shtesë të cilat janë dorëzuar pranë OSHP-së e të cilat më pas i janë prezantuar edhe ekspertit shqyrtues.

Shih Nenin 72, Pika 1. *“Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës”.*

Përgjigje në pretendimin ankimor 3: Sa i përket pretendimit ankimor se komisioni i vlerësimit – ZPP, kanë bërë shkelje ligjore kur kanë rekomanduar për dhënie të kontratës një OE të cilin OE - Medi Health L.L.C. e konsideron të papërgjegjshëm, eksperti shqyrtues sqaron se, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 59 të LPP-së: *“Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës”.* Është obligim ligjor që vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtim me parimet themelore të përcaktuara me LPP, ashtu siç parashihet me nenin 41.1 të RrPP-së: *“Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP”.*

Mbështetur në arsyet e lartcekura Eksperti shqyrtues i rekomandon Panelit Shqyrtues se lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK– Ministria e Shëndetësisë në pajtim me nenin 72 të LPP-së të bëjë sqarimet e duhura dhe vlerësimin ta bëjë në pajtim me nenin 59 të LPP-së dhe Nenin 40 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues nuk është pajtuar me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues, ndërsa operatori ekonomik është deklaruar se pajtohet pjesërisht me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën Nr. 1035/24 të operatorit ekonomik “N.T.SH “M.S.Medicom”

Lidhur me ankesën nr. 1035/24 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: “që ankesa e OE ankues të aprovohet si e pjesërisht e bazuar dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim. OE ankues ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, por sa i përket pretendimit ankimor për qasje në dokumente zyrtare, eksperti shqyrtues vlerëson se katalogët nuk duhet të klasifikohen sekret afarist.”.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1: Eksperti shqyrtues pas analizimit të dokumenteve në platformën e-prokurimi, sqaron si në vijim:

OE në ofertën e dorëzuar, përkatësisht në Pjesën II – Përshkrimi i çmimeve, në Artikullin numër rendor 4 nuk ka ofertuar në pajtim me nenin 40.16 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

“40.16 Në rast se OE, ofron çmimin me 0.00 Euro për një artikull/pozicion të veçantë mund të ketë arsye të ndryshme dhe për këtë arsye nevojitet që të dërgohet një pyetje sqaruese tek Operatori Ekonomik duke kërkuar shpjegim për pozicionin 0.00 Euro.

a. *Nëse Operatori Ekonomik pranon se ai artikull i veçantë nuk është i përfshirë në tender, tenderi duhet të refuzohet.*

b. *Nëse Operatori Ekonomik thotë se ky artikull është ofruar falas, tenderi duhet të refuzohet pasi që dhuratat nuk janë të pranueshme”.*

Në zbatim të dispozitës ligjore të lartcekur, nëse OE nuk ka vlerë monetare për të ofruar për një pozicion, atëherë tenderi duhet të refuzohet pasi që çdo pozicion që kërkohet duhet të ketë çmim. Me këtë dispozitë ligjore synohet shmangja e situatave, të cilat mund të komprometojnë transparencën dhe konkurrencën e drejtë në procesin e prokurimit.

Eksperti shqyrtues ka vërejtur se, në pajtim me nenin 40.16 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, AK ka bërë kërkesë për sqarim tek OE ankues, në mënyrë që të jep një shpjegim për pozicionin 0.00 €.

Në përgjigjen e dhënë pranë AK-së, OE ankues ka sqaruar si në vijim: Pas analizimit të të gjitha dokumenteve, Eksperti shqyrtues konstaton se, OE ankues në Dokumentin - Pjesa II. Përshkrimi i çmimeve – LOT 3, në Artikullin numër rendor 4 ka ofertuar me çmim 0.00 € e jo siç pretendohet në sqarimin e lartcekur, në pikën 1. Madje tek ikona prodhuesi dhe vendi i origjinës është ofertuar me prodhuesin Fresenius Medical Care Deutschland GmbH; Gjermani, por çmimi është ofruar 0.00 €.

Mbështetur në përgjigjen e dytë të OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se, autoritetet kontraktuese gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre të prokurimit, janë të obliguara që të zbatojnë dhe respektojnë Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Sa i përket pretendimit se, oferta duhet të refuzohet vetëm në rastet kur çmimi zero ofrohet për tërë LOT-it e jo për një pozicion eksperti shqyrtues sqaron se, pretendimi i OE nuk qëndron. Kjo duke pas parasysh se neni 40.16 i RrPP-së e thotë qartë se, oferta refuzohet në rast se OE, ofron çmimin me 0.00 Euro për një artikull/pozicion të veçantë.

Në ankesën drejtuar OSHP-së, OE ankues ka pretenduar se, instalimi i artikujve të ofruar, nuk mund të konsiderohet dhuratë pasi që ky pozicion vjen së bashku me artikujt e ofruar për pikën 1, 2 dhe 3 të Specifikimeve, dhe legjislacioni i BE-së i ndalon OE që të faturojë AK me kosto të dyfishtë për pajisje të reja. Sa i përket këtij pretendimi ankimor eksperti shqyrtues sqaron se, OE

ankues ka pas mundësinë që nëpërmjet kërkesës për sqarim të tenderit të qartësojnë përfshirjen e çmimit të instalimit të artikujve të kërkuar, e jo të aludohet se instalimi është i përfshirë në artikujt e ofruar në numër rendor 1, 2 dhe 3 të Përshkrimit të çmimeve.

Mbështetur në arsyet e lartcekura Eksperti shqyrtues konstaton se, pretendimi ankimor i OE-së nuk qëndron. LPP kërkon që ofertat të jenë të arsyeshme dhe të reflektojnë koston reale të shërbimeve ose mallrave të ofruara. Ofertat e dorëzuara me çmim zero ngjallin dyshime për një konkurrencë të padrejtë. OE ankues ka dorëzuar ofertë administrativisht të papërgjegjshme.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2: Eksperti shqyrtues vlerëson se, në zbatim të dispozitës ligjore sipas nenit 11 të LPP-së, AK duhet të ofroj qasje në dokumentet e kërkuara sipas rregullave të lejuara. Në rastin kur dokumentet e caktuara paraqiten si dokumente konfidenciale dhe si të tilla pranohen edhe nga ana e autoritetit kontraktues, atëherë në këtë rast AK sipas këtij neni duhet të krijoj një version të pastruar duke larguar apo fshirë disa elemente të caktuara të informatave në dokumentet përkatëse të cilat janë cilësuar si sekret afarist.

Shih në vijim paragrafin 4 të nenin 11 të LPP-së: *4. Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përgatit versionin e “pastruar” të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka qasje publiku dhe palët e interesuara sipas nenit paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të versionit të tillë të pastruar një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar disa elemente të caktuara të informatës në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesën e operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) versioni i pastruar i bashkangjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe është një kopje e saktë e origjinalit pas heqjes ose fshirjes së informatave të tilla sekrete afariste.*

Sa i përket pretendimit ankimor se, AK ka vepruar kundër ligjshëm duke mos lejuar qasje në emrin e prodhuesit dhe pajisjet e ofruara të operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës, eksperti shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurimi ka vërejtur se, në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim AK ka informuar OE ankues lidhur me emrat e prodhuesve të pajisjeve të OE të rekomanduar për dhënie të kontratës. Megjithatë qasja në katalog nuk ka qenë e ofruar për OE ankues.

AK mos ofrimin e qasjes në dokumentet të cilat janë klasifikuar nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës si sekret afarist, në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, e ka arsyetuar si në vijim” *Neni 11 qartëson se AK ka detyrim të respektojë kërkesat për sekret afarist të paraqitura në OE, për sa kohë këto kërkesa plotësojnë kushtet e përshkruara në ligj. Sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së, operatorët ekonomik kanë të drejtë të kërkojnë që informacionet komerciale të mbrohen si sekrete afariste nëse ato përmbushin kriteret ligjore. AK vendimin e saj e mbështet mbi atë se ka respektuar Aneksin 3 – Kërkesa për Sekret Afarist të dorëzuar nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës”. Madje AK ka deklaruar se, kërkesa për sekret afarist*

është dorëzuar nga të gjithë OE-të përfshirë edhe operatorin ankues N.T.SH."M.S.Medicom".

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues nuk është pajtuar me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues, ndërsa operatori ekonomik nuk pajtohet me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën Nr. 1047/24 të operatorit ekonomik "Interlab" SH.P.K.

Lidhur me ankesën nr. 1047/24 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: "që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim."

Përgjigje në pretendimin ankimor 1: Eksperti shqyrtues vlerëson se, në zbatim të dispozitës ligjore sipas paragrafit 4 të nenit 11 të LPP-së, AK duhet të ofroj qasje në dokumentet e kërkuara sipas rregullave të lejuara. Në rastin kur dokumentet e caktuara paraqiten si dokumente konfidenciale dhe si të tilla pranohen edhe nga ana e autoritetit kontraktues, atëherë në këtë rast AK sipas këtij neni duhet të krijoj një version të pastruar duke larguar apo fshirë disa elemente të caktuara të informatave në dokumentet përkatëse të cilat janë cilësuar si sekret afarist.

Sa i përket pretendimit ankimor se, CE certifikatat dhe Katalogu i prodhuesit nuk paraqesin asnjë rrezik të dëmtimit komercial të grupit sepse këto dokumente janë të prodhuesit, eksperti shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurimi ka vërejtur se, në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim AK ka informuar OE ankues lidhur me emrat e prodhuesve të pajisjeve të OE të rekomanduar për dhënie të kontratës. Megjithatë qasja në katalog nuk ka qenë e ofruar për OE ankues. AK mos ofrimin e qasjes në dokumentet të cilat janë klasifikuar nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës si sekret afarist, në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, e ka arsyetuar si në vijim " *Neni 11 qartëson se AK ka detyrim të respektojë kërkesat për sekret afarist të paraqitura në OE, për sa kohë këto kërkesa plotësojnë kushtet e përshkruara në ligj. Sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së, operatorët ekonomik kanë të drejtë të kërkojnë që informacionet komerciale të mbrohen si sekrete afariste nëse ato përmbushin kriteret ligjore. AK vendimin e saj e mbështet mbi atë se ka respektuar Aneksin 3 – Kërkesa për Sekret Afarist të dorëzuar nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës".*

Madje AK ka deklaruar se, kërkesa për sekret afarist është dorëzuar nga të gjithë OE-të përfshirë edhe operatorin ankues Interlab SH.P.K.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2: Edhe përkundër se dokumenti nuk ka qenë pjesë e kërkesave në FDT, duke pas parasysh se dokumenti është cilësuar si i rremë (falsifikuar) dhe është konsideruar nga ana e OE ankues si shkelje e nenit 65 të LPP-së, eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimin ankimor të Operatorit Ekonomik - Interlab SH.P.K. dhe sqaron si në vijim: ISO Certifikata me numër W-240837-Q, është e lëshuar në emër të N.P.T. MEDICA Sh.p.k. nga Word Quality Registrar (WQR). figuron të jetë trup akreditues nga Word

Accreditation Services (ËAS), e jo siç pretendon OE ankues se është trup akreditues nga IAF.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3: Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit tenderik dhe shkresave të lëndës në platformën e-prokurimi, përkatësisht pretendimit ankimor të OE ankues, sqaron si në vijim:

- Për pozicionin numër rendor 8, operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës në dokumentin - Përshkrimi i çmimit ka ofertuar me prodhuesin Gima, ndërsa në katalogun e dorëzuar me ofertë për këtë pozicion është ofruar produkti i prodhuesit turk Turmed. Në rastin konkret OE ka ofruar katalog nga një prodhues tjetër dhe ka vendosë përshkrim çmimi nga një prodhues tjetër, duke ofertuar kështu edhe në kundërshtim me nenin 4.1 të FDT-së, ku AK nuk ka lejuar variantet: *“4.1 Përveç nëse është e shënuar ndryshe në FDT, tenderuesit nuk janë të autorizuar të dorëzojnë tender që propozon ndonjë furnizim i cili është në pajtueshmëri me një variant të specifikimeve teknike”*. Në rastin konkret, kur në specifikim teknik të dorëzuar nga ofertuesi është përmendur një prodhues, ndërsa në katalogun e ofruar figuron një prodhues tjetër dhe në rastin kur variantet nuk janë të lejuara, një mospërputhje e tillë është e papranueshme, dhe oferta konsiderohet e papërgjegjshme. Kjo mospërputhje edhe nëse sqarohet nuk mund të ndryshojë rezultatin e ofertës si të papërgjegjshme.
- Për pozicionin numër 14, 27 dhe 120, eksperti shqyrtues konstaton se, në ofertën e dorëzuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës përveç që është nënshkruar Aneksi 1 Specifikimet teknike të detyrueshme i Dosjes së tenderit dhe në Përshkrim të çmimeve është ofertuar me prodhuesin italian GIMA S.P.A., nuk është dorëzuar ndonjë katalog për produktet e ofruara. OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ofertuar në pajtim me kërkesën numër rendor 2 të kapacitetit teknik dhe profesional të FDT-së

Shih në vijim kërkesën e AK-së : *“Kërkesa 2. Operatori Ekonomik duhet të prezantojë katalogun (broshurën) e pajisjeve të ofruara, ku produktet dhe specifikat teknike të ofruara duhet të jenë të nënvizuara qartë. Në rast se prezantohet broshura, duhet të specifikohet edhe linku i faqes zyrtare të prodhuesit ne internet, ku mund të gjendet kjo broshurë.*

Dëshmia 2. Katalogu (broshura) e pajisjeve të ofruara me selektim të qartë të produkteve dhe specifikave teknike të ofruara, së bashku me linkun e faqes se prodhuesit”.

- Për pozicionet me numër rendor 26, 29, 35, 36 dhe 145, në ofertën e OE-së janë dorëzuar katalogë të prodhuesin GIMA S.P.A.
- OE i rekomanduar për dhënie të kontratës posedon autorizimin e prodhuesit GIMA S.P.A. dhe katalogët për këto produkte janë dorëzuar nga ky prodhues.
- Ndërsa sa i përket pozicioneve me numër rendor 85, 130 dhe 155, eksperti shqyrtues konstaton se, në ofertën e dorëzuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës përveç që është nënshkruar e vulosur Aneksi 1 Specifikimet teknike të detyrueshme i Dosjes së tenderit dhe në Përshkrim të çmimeve është ofertuar me prodhuesin kinez Ari Medical Technology Co. Ltd., nuk është dorëzuar ndonjë katalog për produktet e ofruara. OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ofertuar në pajtim me kërkesën numër rendor 2

të kapacitetit teknik dhe profesional të FDT-së.

- OE i rekomanduar për dhënie të kontratës posedon autorizimin e prodhuesit Ari Medical Technology Co. Ltd.

Mos dorëzimi i katalogëve bie në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara nga AK në dosje të tenderit/njoftim për kontratë. Madje mungesa e specifikacionit teknik dhe katalogut është e qartësuar edhe në Udhëzuesin Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, të cilin e gjeni në vijim:

Mbështetur në arsyet e lartcekura eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që lënda të anulohet. OE i rekomanduar për dhënie të kontratës është i papërgjegjshëm dhe AK nuk ka vlerësuar në pajtim me nenin 59 të LPP-së dhe nenin 40 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues nuk është pajtuar me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues, ndërsa operatori ekonomik është deklaruar se pajtohet me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në uebfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur. Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në këtë rast.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka mbajtur seancë dëgjimore me datën 02.12.2024, ku ka ftuar të gjitha palët për ti ngritur pretendimet ankimore. Gjate seances degjimore jane administruar provat sikurse ne raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyruar për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatoreve Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit.

Lidhur me pohimet ankimore 2024/1047 të OE ankues "Interlab" SH.P.K, për LOT 1. Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre deklaratat e tyre ne seancën dëgjimore të dates: 02.12.2024, dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij nuk janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë nuk e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes. Paneli Shqyrtues nuk e mbështet këtë konstatim të ekspertit shqyrtues dhe po ashtu, konsideron se edhe për kundër këshillës juridike të dhënë nga AK në Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar, të datës 09.10.2024, "Interlab" Sh.p.k, (tani i OE ankues) nuk ka shfrytëzuar të drejtën e ankesës ndaj atij këtij eliminimi ku AK-ja ka eliminuar nga kjo procedur per shkak se nuk ka permbushur formularin si duhet ku ne listene cmimeve tek kolona prodhuesi dhe vendi i origjines mungon pershkrimi – emri i prodhuesit, poashtu për 12 artikuj (5,80,84,8586,87,90,91,118,129,130,131), mungojne specifikacionet teknike, si dhe ka ofruar produkte qe nuk jane sipas specifikacione teknike te detyruara siq percaktohet me nenin 28 te LPP-se për disa pozicione ku ky OE me ankesë te paraqitur nuk ka atakuar eliminimin e ofertës se tije konform dispozitave ligjore konkretisht nenit 108/A, nëse si palë e pakënaqur kundër vendimit të AK edhe sipas nenit 109 të LPP në OSHP, pastaj nëse është e nevojshme edhe në gjykata kompetente. Këtë nuk e ka bërë dhe si rrjedhojë është pajtuar me eliminimin e tij për këtë aktivitet të prokurimit, por i njëjti paraqet vetëm pretendimi ndaj OE të rekomanduar për kontratë. Në momentin kur një OE pajtohet me eliminimin e tij duke mos e atakuar vendimin e AK dhe duke mos pretenduar se është i përgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit, ky OE nuk mund ta ketë statusin e palës pa interes konform nenit 4.1.26 të LPP. Për këto çështje OSHP qëndron konsistente në vendimet e saja sa i përket kësaj çështje. Ky konstatim ndërlihet edhe me njoftimin e publikuar në ueb faqen e OSHP të datës 09.02.2023, ku i lajmëron AK/OE, se OE për të kualifikuar si palë me interes janë të obliguar të paraqesin pretendime ankimore të cilat synojnë të mbrojnë eliminimin e tyre, në të kundërtën kualifikohen si palë pa interes, pika a) nëse ankuesi nuk prezanton asnjë fakt apo fakte dhe provë përkitazi me vërtetimin e fakteve të pohuara se nuk qëndron dhe/ose është kundërligjor vlerësimi, respektivisht akti i atakuar i AK për eliminimin e tij/sajë dhe /ose nuk argumenton faktin /pohimin bazë se është i përgjegjshëm për aktivitetin e prokurimit për të cilin ka ushtruar ankesë.

Në kontekstin shpjegimeve si më sipër, Paneli i vuri në zbatim po ashtu nenin 103, të LPP, sipas të cilit, “Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term (“palë e interesuar”) në nenin 4 të këtij ligji”. Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar në këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP. Andaj, operatori ekonomik ankues me rastin e parashtrimit të kësaj ankese nuk ka arritur të dëshmoi interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit. Andaj, paneli shqyrtues operatorin ekonomik ankues për këtë aktivitet të prokurimit e sheh si palë pa interes juridiko material, konform nenit 4, paragrafi 1.26 i LPP-së, i cili citon: “Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar.” Këtë vendim Paneli shqyrtues e mbështet edhe tek neni 31, paragrafi 2 i Rregullores së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit nr.83/20.

Nga ana tjetër Paneli Shqyrtues nuk lëshohet në shqyrtimet e pretendimeve tjera dhe AK mban përgjegjësi konform nenin 59.1 lidhur me vlerësimin e bere kundrejt OE të rekomanduar ndërlidhur edhe me nenin 24.2 të LPP-së. atëherë paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivel qendror dhe lokal) gëzon autonomi në projektin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen bërë (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendosin po ashtu edhe për OE të rekomanduar për marrjen e kontratave edhe në neni 24 paragrafi 2 i LPP cituar “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të mbajtur që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të këtyre kontratave të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Lidhur me pohimet ankimore sipas nr 2024/1034 të OE ankues "Medi Health" L.L.C. për LOT III.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre në seancën dëgjimore të dates: 02.12.2024, si dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij nuk janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë nuk e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Paneli Shqyrtues nuk e mbështet këtë konstatim të ekspertit shqyrtues dhe po ashtu, konsideron se edhe për kundër këshillës juridike të dhënë nga AK në Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar, të datës 09.10.2024, "Medi Health" LLC, (tani OE ankues) nuk ka shfrytëzuar të drejtën e ankesës ndaj atij këtij eliminimi ku edhe gjate seances ky OE e pranoj qe ne oferte i mungon Deklarata nen Betim nga konzerciumi e qe eshte kushte administrative , ku edhe Udhezuesi per Prokurim Publik qarte e precizon qe kur mungon Beklarata nen Betim refuzo tenderin , dhe konform dispozitave ligjore konkretisht nenit 108/Ai LPP-se , nëse si palë e pakënaqur kundër vendimit të AK edhe sipas nenit 109 të LPP në OSHP, pastaj nëse është e

nevojshme edhe në gjykata kompetente. Ky OE këtë nuk e ka bërë , dhe si rrjedhojë është pajtuar me eliminimin e tij për këtë aktivitet të prokurimit, por i njëjti paraqet vetëm pretendimi ndaj OE të rekomanduar për kontratë. Në momentin kur një OE pajtohet me eliminimin e tij duke mos e atakuar vendimin e AK dhe duke mos pretenduar se është i përgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit, ky OE nuk mund ta ketë statusin e palës pa interes konform nenit 4.1.26 të LPP. Për këto çështje OSHP qëndron konsistente në vendimet e saja sa i përket kësaj çështje. Ky konstatim ndërlihet edhe me njoftimin e publikuar në ueb faqen e OSHP të datës 09.02.2023, ku i lajmëron AK/OE, se OE për të kualifikuar si palë me interes janë të obliguar të paraqesin pretendime ankimore të cilat synojnë të mbrojnë eliminimin e tyre, në të kundërtën kualifikohen si palë pa interes, pika a) nëse ankuesi nuk prezanton asnjë fakt apo fakte dhe provë përkitazi me vërtetimin e fakteve të pohuara se nuk qëndron dhe/ose është kundërligjor vlerësimi, respektivisht akti i atakuar i AK për eliminimin e tij/sajë dhe /ose nuk argumenton faktin /pohimin bazë se është i përgjegjshëm për aktivitetin e prokurimit për të cilin ka ushtruar ankesë.

Në kontekstin shpjegimeve si më sipër, Paneli i vuri në zbatim po ashtu nenin 103, të LPP, sipas të cilit, “Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term (“palë e interesuar”) në nenin 4 të këtij ligji”. Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar në këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP. Andaj, operatori ekonomik ankues me rastin e parashtrimit të kësaj ankese nuk ka arritur të dëshmoi interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit. Andaj, paneli shqyrtues operatorin ekonomik ankues për këtë aktivitet të prokurimit e sheh si palë pa interes juridiko material, konform nenit 4, paragrafi 1.26 i LPP-së, i cili citon: “Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar.” Këtë vendim Paneli shqyrtues e mbështet edhe tek neni 31, paragrafi 2 i Rregullores së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit nr.83/20.

Nga ana tjetër Paneli Shqyrtues nuk lëshohet në shqyrtimet e pretendimeve tjera dhe AK mban përgjegjësi konform nenin 59.1 lidhur me vlerësimin e bere kundrejt OE të rekomanduar ndërlihet edhe me nenin 24.2 të LPP-së. atëherë paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivel qendror dhe lokal) gëzon autonomi në projektin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen bërë (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasurit të drejtë të vendosin po ashtu edhe për OE të rekomanduar për marrjen e kontratave edhe në neni 24 paragrafi 2 i LPP cituar” Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të mbajtur që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të këtyre kontratave të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Lidhur me pohimet ankimore nr 2024/1035 të OE ankues “NTSH MS Medicom” për LOT III.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre ne seancën dëgjimore të dates: 02.12.2024, si dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit dhe konstato se i njëjti nuk është i përgjegjshëm administrativisht duke mos ofruar fare çmim në njërën prej kolonave. Tek lista e Çmimeve ne artikullin nr rendor 4 ka vendosur çmimin 0.00, PSH konstaton se sipas Rregullorën për prokurim Publik Neni 4, paragrafi ,40.16 (b) e çartëson në ato raste kur ofrohet çmimi 0.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorëve Ekonomik duhet të aprovohen si pjesërisht të bazuara , ndërsa lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën ne Podujevë” me numër të prokurimit 206-24-8799-1-1-1 mbetet në fuqi B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-së .

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj” lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës" poashtu edhe neni 59.4 citohe “4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 dhe paragrafi 4 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - Medi Health L.L.C., N.T.SH."M.S.MEDICOM", Interlab SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: